

Emblemat e para të UÇK-së ishin shtypur në një fabrikë tekstili në Zvicër. Ardhja e tyre për në Kosovë, siç tregon Adnan Asllani - aktivisti që bëri emblemën e UÇK-së - ishte përcejellë me vështirësi të njëjta sikurse edhe armatimi që hynte për ushtarët e UÇK-së.

Stema e UÇK-së, që e bëri Asllani, ishte bartur edhe nga Adem Jashari. Nuk kishte pasur kundërshtime në LPK për versionin që ishte prezantuar.

“Si për ironi më kujtohet se shumë vonë, diku në verë 1998, pasi emblemat ishin shpërndarë në mesin e luftëtarëve, e ashtuquajtura Ministri e Mbrojtjes e Qeverisë së Bukoshit kishte marrë vendim t’i aprovonte emblemat e UÇK-së”, thotë krijuesi i stemës së UÇK-së.

Asllanit nuk i kishte kërkuar askush leje, që stema që kishte krijuar të përshtatej edhe për UÇPMB-në dhe UÇK-në në Maqedoni. /Zëri/